



**Je emigtante
në Itali...**

**e ke nevojë
per ndihmë?**

Të kanë gënjyer me premtime të rreme për punë?
Të kërcënon ai që të ka gënjyer?
Je pa dokumenta? Të shfrytëzojnë?
Je e detyruar të bësh punë të paligjëshme?
Të detyrojnë të shesësh trupin tënd ose të lypësh?
Të detyrojnë të punosh në një klub nate ose gjetiu?
Dikush të merr lekët që ke fituar?

Kërko informacion dhe ndihmë
në numrin falas:

800.290.290

(24 orë rrjesht)

të përgjigjen në gjuhën tënde

Do të kesh mundësinë të gjesh **mbrojtje** në një vend të fshehtë dhe të sigurt. Do të ndihmojnë të mësosh italiasht, të gjesh punë dhe banesë.

Do të kesh mundësi të pajisesh me **lejeqëndrim (permesso di soggiorno)** të rinovueshëm që të jep mundësinë të punosh e të qëndrosh në Itali.

Në Itali prostitucioni nuk është krim.

Krim bën kush shfrytëzon prostitucionin dhe kush shtrëngon një person tjetër të shesë trupin, të lypë o të punojë

Në se do që të ndihmojnë:

Nuk je e detyruar te denoncosh shfrytëzuesit e tu.

Do të mund **të dëshmosh qe ke qenë viktimë e dhunës dhe shfrytëzimit** duke treguar historinë tënde. Në se shfrytëzuesit do të procesohen mund të thërrasin për të dëshmuar.

Mund të qëndrosh në Itali e të marrësh pjesë në një program social që të jep mundësinë të marrësh një lejeqëndrimi për arsye humanitare që (në fund të programit) mund të ndërrohet në lejeqëndrim për arsye pune.

Mos harro që mund të **zgjedhësh që të kthehesh edhe në vendin tënd** nëpërmes "Riatdhesimit vullnetar të asistuar" (nje organizate do të paguajë udhëtimin dhe do të mundohet të lehtësojë kthimin në shtëpi).

Në Itali mund të punojë rregullisht

Kush merr **vizë pune** dhe bën kërkesë për **lejeqëndrim për arsye pune**.

Viza për punë lëshohet nga Ambasada ose nga Konsullata italiane në vendin tuaj vetëm nëse **një punëdhënës** italian (ose i huaj me lejeqëndrim) ka **autorizim** për t'ju thirrur **mbi bazën e kuotave** të hyrjes për çdo vit.

Nëse arrin në Itali si **turiste**, mund të kërkosësh punë, porse për të punuar duhet patjetër të kthehesh në vendin tënd për t'u thirrur nga punëdhënësi sipas mënyrës së përshkruar më sipër.

Thirrja mbi bazën e kuotave zakonisht bëhet një herë në vit: merr informacion në Zyrën e Punës (Direzione Provinciale del Lavoro)!

Edhe nëse hyn si turiste duhat të bësh kërkesë **brenda 8 ditëve** në Kuesturë për **lejeqëndrim turistik**. Nëse nuk e bën këtë qëndron ilegalisht dhe mund të të largojnë (të japin ekspuls).

Nëse nuk je me dokumenta të rregullta, për të legalizuar pozicionin duhet patjetër të kthehesh në vendin tënd!

Mos i beso kujt të premton të punosh ligjërisht jashtë këtyre rregullave!

Ekspulsioni ose fletë largimi (Espulsione o foglio di via)

Nëse nuk ke pashaportë dhe lejeqëndrim të rregullt nuk mund të qëndrosh e të punosh rregullisht në Italia, pra mund të marrësh ekspuls nga Italia dhe rrezikon të pezullosh mundësinë e rihyrjes ligjërish për shumë vite.

Edhe pse je pa dokumenta ose i parregullt ligji italian të siguron disa të drejta:

- 1. Të drejtën e shëndetit**
- 2. Mbrojtjen e shtatzanisë**
- 3. Mbrojtjen për të vegjëlit nën 18 vjeç**

1. E drejta e shëndetit

Edhe pa lejeqëndrim ke të drejtë për **kurimet urgjente** dhe **esenciale**.

Për të arritur këtë duhet të bësh regjistrimin STP (Banor i huaj provizor) pranë Njesisë shëndetësore (Azienda Sanitaria ASL) në vendin ku banon ose në zyrën e spitalit ku jepet tesera STP (falas). Kujto të pyesësh në cilët ambulatorë bëjnë vizitat dhe kurimin (falas ose me pagesa minimale).

Tesera duhet përtërirë në çdo gjashtë muaj, në sejcilën prej njësive shëndetësore dhe vlen në të gjithë territorin italian.

Nëse ke nevojë për kura urgjente mund të shkosh tek **Urgjenca** e spitalit edhe pa e pasur taserën STP. Nëse ke probleme shëndetësore seksuale drejtoju Konsultores Familiare!

Nëse ke nevojë për **ambulancën** telefono numrin falas 118.

Ke të drejtë të bësh **falas testin për virusin HIV (AIDS)**, për të gjitha sëmundjet infektive, për epatitin dhe sëmundjet që transmetohen mes seksit.

Ke të drejtë të bësh **falas testin për virusin HIV (AIDS)**, për të gjitha sëmundjet infektive, për epatitin dhe sëmundjet që trasmetohen mes seksit.

Ke të drejtë për kontrollet e kontraceptimit (parandalimin e shtatzanisë). Kurimet janë falas ose me shuma minimale.

Në bazë të ligjit Njësia Shëndetësore dhe mjekët **nuk mund të të denoncojnë tek Karabinierët** për faktin se je “klandestine”.

2. Mbrojtja e shtatzanisë

Në se je shtatzanë **nuk mund të bejnë ekspuls** deri sa fëmija i sapolindur të mbushë gjashtë muaj.

Ke të drejtë për **asistencë sanitare** falas për shtatzaninë dhe në gjashtë muajt pas lindjes: për këtë duhet t'i kërkohesh Kuesturës një lejeqëndrim për arsye “shëndeti” dhe tek ASL (Njësia Shëndetësore Lokale) tesserën shëndetësore.

Në se do të **ndërpresësh shtatzaninë** (abort) mund t'a bësh brenda 90 ditëve në një spital publik, falas dhe ligjërisht.

Në se nuk mundesh ose nuk do të mbash fëmijën mund t'a lësh në spital pa bërë asnjë krim, edhe pa e lënë emrin. Dikush do të kujdeset për të dhe do të bëjë birësimin.

3. Mbrojtja në se je nën 18 vjeç

Je në moshën nën 18 vjeç? Nuk mund të japin ekspuls se je e mitur!

Në se je **vetëm**, thirr **numrin falas 800290290**, ose Policinë në numrin falas 113 ose **Karabinieriët** në numrin falas 112. Do të gjesh ndihmë!

Ke gjithnjë të drejtë për studim dhe kura mjeksore.

Mund të bashkohesh me familjen. Mund të marrësh një lejeqëndrim që me **mbushjen e 18 vjetëve** mund të kthesh ne motiv studimi ose pune.

Njëkohësisht nuk mund t'u jepet ekspuls:

- a. personave që rrezikojnë dhunën ose vrasjen për arsye politike, fetare, seksuale, ose etnike me kthimin në vendlindje
- b. personat që bashkëjetojnë me bashkëshortin ose një të afërm (prindërit, vëllezërit dhe motrat e prindërve, kushërinjtë, nipërit) me nënshtetësi italiane.

Këto persona mund të kërkojnë një lejeqëndrim në Kuesturë.

Në se të kanë sjellë në Itali me kontratë pune për arsye “artistike” dhe të kanë dhënë një lejeqëndrim me këtë diçiturë: all’art. 27, lett. n) del D. Lgs. 286/1998, je e lidhur vetëm me një punëdhënës, nuk mund të ndërrosh punë, as punëdhënës. Ky lejeqëndrim nuk mund të ndërrohet për punë dhe rinovohet çdo herë për një kohë jo më shumë se 6 muaj.

Mund të të kërkojnë të punosh në një klub nate, si spoliareliste ose si porstitutë.

Me këtë kontratë është më e lehtë të të marrin nëpër këmbë.

**Kërko informacion dhe ndihmë
Në numrin falas:**

800.290.290

(24 hours day or night)

të përgjigjen në gjuhën tënde

Ose mund të telefonosh këto numra:



Regione Emilia-Romagna · Regione Veneto · Regione Marche · ARS ·
Caritas di Udine · Kanë bashkëpunuar On the Road Association